

UDHËZIM
Nr. 12, datë 30.5.2022

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR KARTËN E MEMORIES SË TAHOGRAFIT DIGJITAL

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 10211, datë 23.12.2009, “Për miratimin e aktit normative, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, ‘Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahogرافit digjital në Shqipëri’”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Neni 1
Qëllimi

1. Kartat e memories së tahogرافit digjital lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për drejtuesit e mjeteve, të përfshirë në ligjin nr. 9514, datë 18.4.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane ‘Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr. 4 të saj’”, dhe/ose të përfshirë në rregulloren “Për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 10.9.2008.

Neni 2
Tarifat e lëshimit të kartave të memories për tahogرافin digjital

1. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për drejtuesit e mjetit të përmendur në pikën 1 të nenit 1, është në shumën 40 euro.
2. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për kompanitë e transportit rrugor dhe ofiçinave të tahogرافit është në shumën 40 euro.
3. Karta e tahogرافit digjital për personat e kontrollit dhe/ose grupet e kontrollit lëshohet pa pagesë.
4. Tarifa për rinovimin, zëvendësimin dhe ndryshimin e kartës së tahogرافit digjital, të përmendura në pikat 1 dhe 2, është e njëjtë me tarifën e lëshimit për herë të parë.
5. Rinovimi, zëvendësimi dhe ndryshimi i kartës së tahogرافit digjital, të përmendur në pikën 3 kryhet pa pagesë.

Neni 3

Në tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim është e përfshirë TVSH-ja.

Neni 4

Udhëzimi nr. 9293/1, datë 8.6.2011, “Për përcaktimin e tarifës për kartën e memories së tahogرافit digjital”, shfuqizohet.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

